



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. _____ Prot

Date 29.08.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 29.08.2025

Drejtuar: RRODHE - CONSTRUCTION Shpk me Nipt **L43123001J** me adrese Berat Otllak Fshati Dushnik, lagjja " Parangua ", godine nje kateshe nr.15 , zona kadastrale nr.1587, me numer pasurie 1557

Operatorit Ekonomik (OE) _____ **x** ose
[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐
[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **x**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **x**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: _____ pune

Procedura e prokurimit/lotit: **PROÇEDURË E HAPUR**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF - 53391 - 07- 03-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: « **RIKONSTRUKSION I QENDRES RINORE LAPARDHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: brenda 12 muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 04.07.2025

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 34 datë 7 Korrik 2025

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. FLED Shpk me Nipt K17621104C me oferte 12 240 980 (dymbëdhjete milion e dyqind e dyzete mijë e nentëqind e tetëdhjete) Lekë pa Tvsh.
2. RSM COMPANY Shpk me Nipt 810802422 me oferte 15 103 560 (pesëmbëdhjete milion e njëqind e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjete) Lekë pa Tvsh.
3. RRODHE - CONSTRUCTION Shpk me Nipt L43123001J me oferte 15 459 705 (pesëmbëdhjete milion e katërqind e pesëdhjete e nente mijë e shtatëqind e pese) Lekë pa Tvsh.
4. BOE NEWGEN me Nipt L92014008U & INERTI me Nipt J66926804L me oferte 15 496 982 (pesëmbëdhjete milion e katërqind e nentëdhjete e gjashtë mijë e nentëqind e tetëdhjete e dy) Lekë pa Tvsh.
5. NIKA Shpk me Nipt J76705047U me oferte 15 887 740 (pesëmbëdhjete milion e tetëqind e tetëdhjete e shtate mijë e shtatëqinde e dyzete) Lekë pa Tvsh.
6. AVDULI Shpk me Nipt J66703306O me oferte 15 964 250 (pesëmbëdhjete milion e nentëqind e gjashtëdhjete e katërmijë e dyqind e pesëdhjete) Lekë pa Tvsh.
7. INA Shpk me Nipt J61814009W me oferte 16 196 556 (gjashtëmbëdhjete milion e njëqind e nentëdhjete e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjete e gjashtë) Lekë pa Tvsh.
8. BOE TOTILA me Nipt K13001010G & “METEO” me Nipt L26310801C me oferte 16 239 556 (gjashtëmbëdhjete milion e dyqind e tridhjetë e nente mijë e pesëqind e pesëdhjete e gjashtë) Lekë pa Tvsh.
9. BOE BESTA Shpk me Nipt J62903182B & 3 EL KONSTRUKSION Shpk me Nipt M03002001N me oferte 17 142 360 (shtatëmbëdhjete milion e njëqind e dyzete e dy mijë e treqind e gjashtëdhjete) Lekë pa Tvsh.
10. KEVIN KONSTRUKSION Shpk me Nipt K71401004W me oferte 17 266 522 (shtatëmbëdhjete milion e dyqind e gjashtëdhjete e gjashtë mijë e pesëqind e njëzete e dy) Lekë pa Tvsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm.

1. FLED Shpk me Nipt K17621104C Oferta e operatorit ekonomik 12 240 980 (dymbëdhjetë milion e dyqind e dyzete mijë e nentëqind e tetëdhjetë) Lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe konformë kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të tenderit konkretisht :

Oferta e operatorit ekonomik në bazë të Nenit 93 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” i ndryshuar, dhe Nenit 82 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik ” i ndryshuar, është konstatuar anomalisht e ulët nga të gjitha ofertat e vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në Nenin 93 pika 5 të Ligjit Nr.162/2020 “ Për Prokurimin Publik ” i ndryshuar, oferta refuzohet.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

2. BOE NEWGEN me Nipt L92014008U & INERTI me Nipt J66926804L Oferta e operatorit ekonomik 15 496 982 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e dy) Lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit.

Nga verifikimi rezulton se OE INERTI ka paraqitur në formularin e vetdeklarimit 1 (nje) elektriciste por në pikën 2.3.3/b të DST-ve kerkohen 2 (dy) Elektricistë. Nuk është deklaruar nga BOE 1 (nje) elektriciste. Në formularin e deklarimit mjeti me targe TR4574N afati i kontratës 08.10.2020 (me afat 5 vjecar) nuk përmbush afatin për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, pasi sipas grafikut të punimeve objekti është 12 muaj.

Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit BOE NEWGEN me Nipt L92014008U ka marrë përsipër 37% të punimeve & INERTI me Nipt J66926804L ka marrë përsipër 63 % të punimeve. Në formularin e deklarimit OE NEWGEN ka deklaruar vetëm 2 punonjes për përmbushjen e pikës 2.3.3/b të DST-ve jo në raport me përqindjen e punimeve marrë përsipër nga totali prej 20 punonjesh të kërkuar.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

3. NIKA Shpk me Nipt J76705047U Oferta e operatorit ekonomik 15 887 740 (pesëmbëdhjetë milion e teteqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzete) Lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit.

- Operatori ekonomik ka deklaruar Drejtuese teknike i angazhuar do të jetë znj. Gentiana Mosko por rezulton se ky drejtues teknik është deklaruar gjatë gjithë kohës të objekti me Nr. REF-51140-06-13-2025 me objekt “Rikonstruksion total i shkollës së mesme të bashkuar Koco Brisku-Lapardha” me AK Bashkia Berat. Ky inxhinier nuk mund të jetë i prezent në kantier në të dy objektet njëkohësisht në shkelje të neneve 2 e 4, Kreu I të Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimi”.

- Rezulton se të preventivi i punimeve për zërin “Punime të rrjeteve e pajisje hidraulike” nuk është ofertuar me cmim.

- Rezulton se stafi dhe mjetet i deklaruar në formularin e deklarimit janë deklaruar në procedurën e prokurimit me Nr. REF-51140-06-13-2025 me objekt “Rikonstruksion total i shkollës së mesme të bashkuar Koco Brisku-Lapardha” me AK Bashkia Berat nga ku operatori ekonomik ka rezultuar fitues.

4. INA Shpk me Nipt J61814009W

Oferta e operatorit ekonomik 16 196 556 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit.

Në piken 3.2/b të DST-ve është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me license leshuar nga QKL “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transportin e mbetjeve të ngurta). Nga verifikimi rezulton se operatori ofertues ka paraqitur licensën “Kodi III.2.B” Për transportin e mbetjeve të ngurta duke mos përfshirë grumbullimin sipas kërkesave në këtë pikë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos kualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga ofertuesi i renditur i pari **RSM COMPANY Shpk** me Nipt **810802422** me ofertë 15 103 560 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e pesëqind e gjashtedhjetë) Lekë pa Tvsh, në sistemin e prokurimit elektronik paraqitjen e dokumentave provuese dhe dokumentat e tjera shoqëruese jo më vonë se 5 (pesë) ditë me qëllim verifikimin e tyre dhe vazhdimin e procedurës sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e vetëdeklarimit, dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës me Nr. 4753 prot. Dt. 19.08.2025, nga ku komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar dokumentacionin

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit, konkretisht :

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës : Pasi operatori ekonomik për mjetin me targe 01-463-EI dhe për mjetin me targe 01-941-DS ka paraqitur policen e sigurimit dhe kontrollin teknik të skaduar prej datave 26.09.2024, 25.05.2025 kjo në kundërshtim me kërkesat e dokumentave të tenderit.

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës : Pasi Fadroma me goma e paraqitur nga ky ofertues nuk përmbush pikën 2.3.7/a të DST e cila citon : a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

- Punonjësi F.R deklaruar si manovrator nuk figuron në listepagese e dorëzuar për muajin e fundit pasi operatori ekonomik ka deklaruar vetëm mjete në pronësi. Operatori ekonomik nuk plotëson 2.3.4/b të DST e cila citon : për operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar Manovrator 1 (një).

- Në bazë të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Shtojca 8 dhe të dhënave të pasqyruara në listën e punonjësve, konstatohet se punonjësit E.D dhe H.F janë me status “Primare = JO”. Kjo sjell konfuzion nëse këta punonjës mund të konsiderohen si të angazhuar pranë operatorit ekonomik, duke përmbushur kështu kërkesën e dokumentacionit të tenderit lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar sipas listës së muajit të fundit. Për rrjedhojë operatori ekonomik nuk e përmbush pikën 2.3.3/b të DST-ve në lidhje me disponimin e stafit të specializuar dhe të paangazhuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Si rrjedhim operatori ekonomik RSM COMPANY Shpk me Nipt 810802422 me vlerë të ofertuar 15 103 560 (pesëmbëdhjetë milion e njëqindë e tre mijë e pesëqindë e gjashtëdhjetë) Lekë pa Tvsh, skualifikohet.

Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga ofertuesi i renditur i pari **RRODHE - CONSTRUCTION Shpk** me Nipt **L43123001J** me ofertë **15 459 705 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e nente mijë e shtatëqind e pese) Lekë pa Tvsh**, në sistemin e prokurimit elektronik paraqitjen e dokumentave provuese dhe dokumentat e tjera shoqëruese jo më vonë se 5 (pesë) ditë me qëllim verifikimin e tyre dhe vazhdimin e procedurës sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e vetëdeklarimit, dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës nga ku komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar dokumentacionin.

KVO pasi përfundoi vlerësimin, njofton njësinë për vazhdimin e procedurës në sistem.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **RRODHE - CONSTRUCTION Shpk** me Nipt **L43123001J**, me ardese Berat Otllak Fshati Dushnik, lagjja " Parangua ", godine nje kateshe nr.15 , zona kadastrale nr.1587, me numer pasurie 1557 , me oferte ekonomike **15 459 705 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e nente mijë e shtatëqind e pese) Lekë pa Tvsh** [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".